

Konsultimet rajonale me komunitetet jo-shumicë mbi Inicativën për themelimin e KOMRA-së

Shkup, Maqedoni
29. janar 2011.

Konsultimet rajonale me përfaqësuesit e komuniteteve jo-shumicë janë mbajt në Shkup me 50 pjesëmarrës nga tërë hapësirat e ish Jugosllavisë. Takimin e hapi Gordana Duvnjak (Këshilli koordinues i Koalicionit për KOMRA-në, anëtare nga Maqedonia), Tatko Gajica (Parlamenti Kroat), Shaip Kamberi (Kryetar i Komunës së Bujanocit, Serbi). Foli edhe Nataša Kandić (Fondi për të drejtën Humanitare, Serbi). Konsultimet i moderoi Boro Kitanovski (Aksioni për paqe, Prilep, Maqedoni). Për këtë ngjarje kanë raportuar mediet Maqedone dhe Kosovare.

Përmbledhja e rekomandimeve, propozimeve dhe opinioneve të pjesëmarrësve:

Është e domosdoshme të vihet ligji për personat e zhdukur në tërë rajonin. KOMRA duhet të ndihmojë që historia të interpretohet në mënyrë unike.

Nëse e shikoni literaturën nga e cila nxënësit dhe studentët e mësojnë historinë, ata shohin se faktet janë të njëjta, por komentet janë të ndryshme. Le të themi, nëse është faktike se lufta Ballkanike ka filluar në vitin 1912, dhe se ushtria serbe, p.sh, ka hyrë më Shkup. Kjo ngjarje ka qasje tërësisht tjetër në histografinë serbe nga ajo maqedone. Liria apo okupimi i sërishëm? (...) Dhe, nuk mund të them se ata janë nxitësit e luftës, por paraqesin bazën për konflikt, siç edhe kanë qenë për konfliktet e fundit në ish Jugosllavi. Iniciativa për KOMRA për këtë arsye është e domosdoshme. (...) E dyta, dua të propozoj miratimin e ligjit për personat e zhdukur. Kjo është plaga më e dhimbshme, jo vetëm për familjet por edhe për anëtarët e shoqërisë. Ligji i njëjtë i cili do t'u jepet të gjitha shteteve. Pajohem se me këtë ligj u sigurohet lehtësi kriminelëve, gjegjësisht zvogëlim i viteve të dënimit me burg nëse ata japin informata për varrezat masive apo për fatin e personave të zhdukur. (Nexhmedin Spahiu, RTV Mitrovicës, Kosovë, Konsultimet rajonale me komunitetet jo-shumicë mbi Inicativën për themelimin e KOMRA-së, Shkup, Maqedoni, 29. janar 2011.)

Çështje thelbësore se çfarë ka sjellë deri te ajo që njerëzit të cilët do të duhej të ishin normal të bëjnë atë rrëmujë dhe pa kurrfarë ndjeje të përgjegjësisë të kryejnë krime aq të tmerrshme.

Sinqerisht besoj se Ballkani mund të jetë një hapësirë „normale“, ku do të kemi një raport normal ndaj historisë dhe ku historia nuk do të keqpërdoret për qëllime politike. Që ta arrijmë këtë, e kjo sipas meje është ideja e KOMRA-së, duhet ti dimë faktet. Nuk duhet të

frikohemi që të tregojmë me gisht drejt atyre të cilët kanë kryer krim, pa marrë parasysh a janë ata sot në pushtet, se a i pëlqen kjo opinionit publik të Serbisë, Bosnjë e Hercegovinës, Sanxhakut dhe Kroacisë, etj. Këshilli Kombëtarë Boshnjak ia japë mbështetjen KOMRA-së.

(...) Më intereson se a do të hulumtojë KOMRA se cili është shkaku, dhe cila është pasoja. Mendoj se është çështje thelbësore se çka ka sjellë deri te ajo që ata që do të duhej të ishin njerëz normal të bëjnë atë rrëmujë dhe pa kurrfarë ndjenje të përgjegjësisë të kryejnë krime aq të tmerrshme. (Samir ef Tandir, Komuniteti kulturor Boshnjak, Prijepole, Serbi, Konsultimet rajonale me komunitetet jo-shumicë mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Shkup, Maqedoni, 29. janar 2011.)

Duhet të miratohet ligji, sipas të cilit të gjithë kriminelët do të dënohen në të njëjtën mënyrë.

Por kur kemi parasysh këtë temë shumë të ndjeshme, e cila e brengosë tërë rajonin për më shumë se dy dekada, gjetja e zgjidhjes është e domosdoshme. Atëherë, kjo Iniciativë ka nevojë për mbështetje shumë më të gjerë se sa vetëm nga shoqëria civile. (...) Ndërsa, tani, se a do të mund të formohet një platformë në të cilën do të kërkohen elementet e veçanta për procedimin e krimeve të luftës dhe të dënimeve të veçanta? Kjo gjë akoma procedohet kështu që kjo në formë formale është duke u bërë, si një obligim, e jo thelbësore që të sillen para drejtësisë kriminelët e luftës. Ndoshta në këtë atmosferë do të ishte më mirë të aprovohet një ligj i përbashkët. Ligjet e shteteve a i kanë elementet e veçanta, kur bëhet fjalë për këtë problematikë? Kjo është qasja e njëjtë, dhe nëse njeri shtet i miraton këto kritere, e miraton platformën, atëherë krijohet një presion në rajon se kjo gjë duhet miratuar. (Riza Halimi, deputet, Asambleja Nacionale e kuvendit të Republikës së Serbisë, Preshevë, Serbi, Konsultimet rajonale me komunitetet jo-shumicë mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Shkup, Maqedoni, 29. janar 2011.)

Në punën e KOMRA-së duhet përfshirë edhe tregtinë me organe të njerëzve.

Secili krim duhet të gjykohet. Duhet ta gjykojmë edhe tregtinë me organe të njerëzve, gjë që nuk kam dëgjuar se e ka propozuar ndokush. Edhe ky është krim, tmerrësisht i madh. (Ivana Cvetković, Këshilli nacional i pakicës maqedonase, Leskovc, Serbi, Konsultimet rajonale me komunitetet jo-shumicë mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Shkup, Maqedoni, 29. janar 2011.)

Duhet të jemi të qëndrueshëm, kjo nuk do të jetë e lehtë.

Mendoj se KOMRA është e ardhmja dhe se kjo Iniciativë duhet ta ketë një mbështetje të fortë, dhe mendoj se kjo gjë nuk do të jetë e lehtë. Të gjitha gjërat të cilat duhet rrënjësisht

sqaruar në këto hapësira, do të jetë shumë e vështirë. Por duhet të qëndrojmë optimist në këtë çështje. Ndoshta jo në një të ardhme të afërt, jo për një vit apo dy, por kjo gjë duhet të ndodhë. (Stojanča Arsić, Kuvendi Komunal në Bujanoc, Serbi, Konsultimet rajonale me komunitetet jo-shumicë mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Shkup, Maqedoni, 29. janar 2011.)

Si ta ngrisim çështjen e shtëpive të djegura, përndjekjeve, frikësimeve, vrasjeve shpirtërore në Sanxhak.

Neve na duhen përgjegjësitë e pavërtetuara deri më tani, lidhur me krimet e kryera, madje edhe të individëve të cilët janë dënuar. Disa madje janë shpërblyer sepse ka ndodhë një varg i krimeve të rënda në Sanxhak, të cilët kanë mbetur pa u ndëshkuar. Në Ballkan akoma askush nuk është dënuar për vrasjet shpirtërore. Si ta ngrisim çështjen e vrasjeve shpirtërore të njerëzve, gjegjësisht për përndjekjet, për djegiet e shtëpive. Sepse nuk janë viktima vetëm njerëzit e vrarë, çfarë është me frikësimet, çfarë është me proceset. Rreth 17 mijë njerëz janë procesuar dhe dërguar në biseda informative në Sanxhak. Çfarë edhe me atë se edhe në ditët e sotme jetojnë njerëzit të cilët janë përgjegjës për maltretime, tortura në Sanxhak, për përndjekje. (Redžep Škrijelj, Fjala Boshnjake, Novi Pazar, Serbi, Konsultimet rajonale me komunitetet jo-shumicë mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Shkup, Maqedoni, 29. janar 2011.)

Duhet ta gjejmë mënyrën se si mundet opinioni publik të ndikojë te politikanët që të themelojnë KOMRA-në.

Kjo Iniciativë duhet ta arrijë pajtimin. Pasi që pajtimi vetëvetiu është proces i cili do të zgjasë gjatë, mendoj se pa bashkësinë ndërkombëtare nuk mund të presim që parlamentet lokale, të ashtuquajturat elitat politike, do të vijnë deri te një konsensus. Duhet të gjejmë një mënyrë se si të veprojmë në publik, i cili do të sensibilizohet, dhe pastaj ai publik të ndikojë në opinionin e politikanëve të cilët do të ndryshojnë politikën, të cilat nuk janë ato politikën e njëjta të cilat kanë sjellë deri te kjo, dhe nuk janë njerëzit e njëjtë të cilët kanë sjellë deri te kjo. (Mato Groznica, Këshilli Kroat Nacional në Vojvodinë, Serbi, Konsultimet rajonale me komunitetet jo-shumicë mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Shkup, Maqedoni, 29. janar 2011.)

Si ti bindim pjesëtarët e komuniteteve shumicë që të flasin për krimet e grupeve të tyre etnike.

Të gjithë kryesisht kemi folur për krimet e kryera ndaj popullit të tyre, ndaj pakicave të tyre. Megjithatë, askush nuk ka guxim të flasë për krimet të cilat i ka kryer populli i vetë. (...) Si ta binim anëtarin e komunitetit shumicë të flasë për krimet e bërë andaj komunitetit

pakicë? Duhet të gjendet ndonjë mënyrë se si të binden ata njerëz që të flasin. Ne në Bosnjë e Hercegovinë kemi problem sepse jemi në të njëjtin territor, apo, nëse doni ashtu, në të njëjtën rrugë në një jemi komunitet shumicë, në të tjetrën jemi pakicë. (Smajil Žlibanić, Shoqata e qytetarëve të Gradishicës, Gradishicë, BeH Konsultimet rajonale me komunitetet jo-shumicë mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Shkup, Maqedoni, 29. janar 2011.)

Duhet të hulumtojmë se a ka kryer krime ndonjë Rom.

Unë do të dëshiroja që në hulumtimet e krimeve të kyçen edhe Romët të cilët kanë kryer krime në territorin e ish Jugosllavisë. Të shënohet ai kriminel dhe „ndoshta“ edhe në të themi, shih edhe ne kemi kryer krime. A jemi ne ata që kemi shkaktuar situatën që dikush tjetër të kryejë krim ndaj nesh, dhe ku është gabimi? Pra, në këtë moment nuk ka të dhëna, as unë personalisht nuk i di, nuk jam marrë me këtë gjë. (Dervo Sejdić, Këshilli Rom në BeH, Sarajevë, BeH, Konsultimet rajonale me komunitetet jo-shumicë mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Shkup, Maqedoni, 29. janar 2011.)

Do të duhej kushtuar vëmendje të posaçme për ata të cilët dëshmojnë kundër kriminelëve „të tyre“.

Është një njeri i ri, i sakrifikuar Blaž Stevović nga Trebinja i cili ka dëshmuar (kundër pjesëtarëve të komunitetit të tij), pastaj është izoluar nga komunikimi nga ana e komunitetit të tij dhe ka vështirësi shumë të mëdha për risocializim. Prandaj, është shumë e vështirë të paramendohet për të gjetur dhe ta bindim për atë lloj dëshmie, pasi që nuk ekzistojnë mekanizmat e mbrojtjes së tyre. (...) A ekzistojnë ndoshta mekanizmat në nivel ndërkombëtarë, pasi që këto ligjet tona nuk janë të mjaftueshme për mbrojtjen e këtyre njerëzve. Ndoshta kësaj çështjeje do të duhej kushtuar një konsultim të tërë. (Senad Nanić, Shoqëria kulturore e Boshnjakëve të Kroacisë Preporod, Zagreb, Kroaci, Konsultimet rajonale me komunitetet jo-shumicë mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Shkup, Maqedoni, 29. janar 2011.)

Mediat janë kyçe për krijimin e klimës së mirë për themelimin e KOMRA-së.

Unë vlerësoj se për ndryshimin e klimës rolin kyç e kanë mediet. Sepse pa media kjo Iniciativë e mirë nuk do të ketë sukses, nëse nuk e kemi mbështetjen e medieeve unë jam skeptik, por mendoj se do të jetë shumë vështirë. (...) Nëse e kemi bllokimin e medieeve dhe nuk do të informohet publiku i gjerë, atëherë asgjë nuk do të ndryshohet. (Michal Spevak, Shoqata e miqësisë malazeze-slllovaqe, Podgoricë, Mali i Zi, Konsultimet

rajonale me komunitetet jo-shumicë mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Shkup, Maqedoni, 29. janar 2011.)

Hyrjen në BE duhet kushtëzuar me respektimin e të drejtave të njeriut.

Pra, ne duhet ta formojmë këtë institucion, të zgjidhen njerëzit e vullnetit të mirë të cilët do të punojnë në mënyrë transparente, ndershëm, korrekt. Të mos ketë e imja, e jotja apo e tjetrit dhe ne të... Unë në këtë pjesë do ta jepja mbështetjen time për KOMRA-në. (...) KOMRA do të duhej të krijojë dhe t'ia ofrojë kredibilitetin. Statutin sigurisht e hartojnë njerëzit me qëllimin që të jetë i mirë. Në te mund të bëhen vërejtje, nëse nuk do të jetë i tillë. Por, besoni, unë do të insistoja në atë që të pranohemi në BE, por të jenë qëllimet e qarta dhe të thonë – zotërinj, të drejtat e njeriut, të drejtat e njeriut. (Mile Marčeta, Shoqata e qytetarëve të dëbuar nga Komuna në Drvarë, BeH, Konsultimet rajonale me komunitetet jo-shumicë mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Shkup, Maqedoni, 29. janar 2011.)

Të dhënat duhet të jenë të sakta që të shmangët manipulimi.

Unë e kam kuptuar se duhet të shënohen me emër e mbiemër se në Drvarë, në atë dhe atë fshat, është vrarë Mitar Mirić, i lindur në atë dhe atë datë, nga ai prind. Pse? Sepse sot po hartohen disa lista, dhe kjo është e ditur publikisht, ku është thënë se atje në Dërvarë në një fshat serb janë vrarë kaq apo kaq serbë, dhe fund është sqaruar, se në fakt, ata serbë kanë vdekur nga vdekja natyrore. Këtë duhet shmangur në çdo mënyrë. (Fahir Gutic, Shoqata kulturore Boshnjake, Lubjanë, Slloveni, Konsultimet rajonale me komunitetet jo-shumicë mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Shkup, Maqedoni, 29. janar 2011.)

Ka pasë shembuj të rasteve pozitive kur janë shpëtuar njerëzit e nacionaliteteve tjera. Këtë duhet theksuar.

Ka pas një numër të madh të shembujve pozitiv të njerëzve të cilët gjatë luftës kanë shpëtuar pjesëtarët e nacionalitetit tjetër. Ata njerëz janë lënë anash. Këto raste duhet cekur si shembuj pozitiv, se dikush ka shpëtuar tjetrin, sepse janë shpëtuar familje të tëra, në kuptimin e plotë të fjalës në momentin e fundit. Kësi njerëz ka. Vetëm nëse paksa përpiqemi rreth këtyre rasteve dhe ti kërkojmë, ti evidentojmë dëshmitë e tyre, të atyre që i kanë shpëtuar tjerët dhe të atyre që kanë shpëtuar. Unë mendoj se kjo do të mund të ndihmojë në masë të madhe. (Radomir Mičić, Iniciativa demokratike e Serbëve

të Sarajevës, Sarajevë, BeH, Konsultimet rajonale me komunitetet jo-shumicë mbi
Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Shkup, Maqedoni, 29. janar 2011.)